

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetar, Driton Muharremi e Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Kimete Veseli procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit M.Q., për shkak të veprës penale, Vrasje e rëndë nga neni 179 par.1 nënpar. 1.6 dhe 1.9 lidhur me veprën penale bashkim kriminal nga neni 34 par.1 të KPRK që ka mbet në tentativë nga neni 28 të KPRK dhe veprës penale mbajtja në pronësi në kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK, në bazë të ankesës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë, PKR.nr.216/2014 datë 18.12.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 11.05.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë, PKR.nr.216/2014 datë 18.12.2017, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjakovë me aktgjykimin PKR.nr.216/2014 datë 18.12.2017, në bazë të nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPP-së e ka liruar nga akuza të akuzuarin M.Q., për shkak të veprave penale, Vrasje e rëndë nga neni 179 par.1 nën.par 1.6 dhe 1.9 lidhur me veprën penale bashkim kriminal nga neni 34 par.1 të KPRK që ka mbet në tentativë nga neni 28 të KPRK dhe për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK. I akuzuari është liruar nga pagesa e shpenzimeve të procedurës penale në kuptim të nenit 454 par.1 të KPPK dhe mjetet do të paguhen nga mjetet buxhetore.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë ka paraqitur:

- Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe për shkak të shkeljeve të ligjit penal, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën e Prokurorisë si të bazuar dhe aktgjykimin e shkallës së parë ta prishë dhe lëndën ta kthej në rishqyrtim dhe rivendosje.

-Përgjigje në ankesën e Prokurorisë ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit M.Q., av. B.B. i cili ka propozuar që të refuzohet ankesa e Prokurorisë Speciale e Republikës së Kosovës ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Prokurori i Apelit me parashtrësën me shkrim PPA/I.nr.164/2018 të dt.12.04.2018 ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi të anulohet dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesa nuk është e bazuar.

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës në ankesë pretendon se me aktgjykimin e goditur gjykata ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale pasi dispozitivi i aktgjykimit është i paqartë dhe në kundërtënie me vetveten dhe arsyetimin e aktgjykimit. Aktgjykimi nuk është bazuar në faktet dhe provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor ashtu që nuk është vlerësuar çdo provë një nga një e në bazë të vlerësimit të provave të nxjerr përfundime të qarta dhe konkrete lidhur me faktet vendimtare por vetëm është konstatuar cilave prova gjykata ua ka falur besimin e cilave jo pa një arsyetim të bindshëm. Sipas prokurorisë gjendja faktike është vërtetuar gabimisht pasi gjykata ka marr aktgjykim pa e vërtetuar plotësisht gjendjen faktike e që ka ardhë si pasojë e mos vlerësimit në mënyrë të duhur të provave materiale siç janë përgjimet ligjore me të cilat dëshmohej se M.Q. ka biseduar përmes telefonit me A.Sh. e ky me A.Sh. dhe anasjelltas dhe se krejt biseda është zhvilluar lidhur me aktivitetin kriminal respektivisht me vrasjen e cila ka mbetur në tentativë e ku vërtetohet nga ky komunikim se A. nuk ja jep numrin e M.Q. duke dëshiruar që vetë të jetë akter i kësaj ngjarje. Nuk janë vlerësuar drejtë edhe vëzhgimet dhe fotografimet e fshehta e që një gjendje e tillë do të vërtetohet më së miri lpo të vlerësohej dëshmia e dëshmitarit bashkëpunues O.N. të dhënë para gjyqtarit të procedurës paraprake ku ka treguar në teren se ku jan strehuar, ushqyer, me çka jan ushqyer dhe ku i kanë testuar armën. Nuk është vlerësuar fakti se i njëjti hetuesit e policisë i ka dërguar deri në afërsi 10 metra tek shtëpia e viktimës si dhe ka treguar edhe rrugën që M.Q. i ka qar dhe atë rrotull një kodrine ku shihej shtëpia e viktimës shumë mirë duke treguar vendin konkret ku kanë qëndruar dhe ku kanë rruajtur si dhe faktin e rëndësishëm se dëshmitari ka thënë “se e njeh viktimën, familjen e tij, automjetin e tij dhe se e din ku e ka shtëpinë”. Nuk është vlerësuar as deklarata e të dëmtuarit P.R. ku ka theksuar se në restorantin “Olita 1” ka par të akuzuarin me persona të panjohur dhe se deklaron se është përcjellë me automjetin e M.Q.

Gjykata e Apelit me vëmendje ka shqyrtuar aktgjykimin e shkallës së parë, ankesën e Prokurorisë si dhe shkresat e lëndës dhe vlerëson se aktgjykimi i atakuar me ankesë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. I njëjti ka të paraqitura arsyet për çdo pikë të aktgjykimit, është paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pa vërtetuara. Ka vlerësuar saktësinë e provave kundërtënëse si dhe arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve si dhe arsyet me të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së kësaj çështjeje penalo-juridike e veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit apo mos ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit në këtë çështje penale. Gjykata e shkallës së parë në aktgjykim ka dhënë arsyet për faktet vendimtare, ka arsyetuar secilën provë veç e veç duke i ndërlidhur me njëra tjetrën dhe duke e vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike. Gjykata e shkallës së parë ka administruar provat materiale dhe jo materiale dhe atë ka dëgjuar të dëmtuarin P.R., M-K.L., ka dëgjuar dëshmitarët P.R. dhe J.R. si dhe deklaratën e dëshmitarit bashkëpunues G.N. si dhe 67 provave materiale të paraqitura në faqen 12, 13 dhe 14 të aktgjykimit të shkallës së parë e ku pas analizimit dhe

vlerësimit të tyre dhe me të drejtë gjykata e shkallës së parë erdhi në përfundim se nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar nga ana e Prokurorisë. Nga shkresat e lëndës dhe aktgjykimit të shkallës së parë vërtetohet se nga dëshmitë e dëshmitarve P.R., M-K.L. si të dëmtuar, dëshmitarët P.R., J.R. si dhe nga dëshmia e dëshmitarit bashkëpunues ku është lexuar deklaratata e tij O.N., nuk kan mundur ti vërtetojnë pretendimet e prokurorisë se i akuzuari ka bërë porositjen e vrasjes së P.R. dhe M.K.-L., duke mos vërtetuar motivin apo arsyen që i njëjti të porosit kryerjen e kësaj vepre penale duke mos pasur asnjë kontest apo konflikt interesi apo krejt diçka tjetër me të dëmtuarit e që vërtetohet edhe nga dëshmia e kryetares së Komunës së Gjakovës M-K.L. e cila ka deklaruar se për herë të parë për të akuzuarin ka dëgjuar kur është njoftuar për rastin, se me të njëjtin nuk ka pas asnjë biznes e as me ndonjë anëtarë të familjes së tij e që nga kjo nuk mund të vërtetohet as edhe mundësia e të pasurit konflikt interesi me të njëjtin. Sa i përket dëshmitarit bashkëpunues G.N., të njëjtës me të drejtë gjykata e shkallës së parë nuk ia ka falur besimin me arsyetim se e njëjta është kontradiktore jo vetëm me deklaratën e tij por edhe me dëshmitë tjera të administruara në shqyrtimin kryesor e posaçërisht me të dëmtuarën M. K. – L., ku dëshmitari bashkëpunues ka deklaruar se i akuzuari M.Q. kinse ka pas një punë për ta kryer për të dëmtuarën ndërsa e dëmtuara M. nuk ia ka paguar të hollat por ja ka dhënë parat jo të vërteta me ngjyrë si dhe në dëshminë që e ka dhënë tek organet e ndjekjes në Tropojë ka përmendur një shumë prej 86.000.000,00 e që jo vetëm për gjykatën e shkallës së parë por edhe për këtë gjykatë kjo shumë aq e madhe është e pa besueshme për tu besuar se e dëmtuara ti ketë pasur të njëjtat ndërsa në anën tjetër dëshmia e të dëmtuarës vërteton se jo veç që nuk ka pasur ndonjë biznes me të akuzuarin por as që e ka njohur të njëjtin derisa është njoftuar për rastin nga policia. Po ashtu me të drejtë gjykata e shkallës së parë nuk ia ka falur besimin dëshmisë së këtij dëshmitari bashkëpunues edhe në pjesën që ka të bëjë me përgjimit nga ana e policisë së Kosovës lidhur me bisedat që i ka pasur me A. S.n duke insistuar duke insistuar gjatë bisedës për të kërkuar nga A. për të biseduar me M. por pa u sqaruar për çka ndërsa nga transkriptet vërtetohet se A. nuk dinte se për çka e ka fjalën dëshmitari G. dhe se gjatë tërë kohës sa dëshmitari bashkëpunues ka qenë në përgjimit nuk ka kontaktuar me të akuzuarin M.dhe po ashtu faktit se autoritetet shqiptare po të kishte diçka konkrete nuk do ta lironin A. Sh. dhe G.N.n. Edhe dëshmie tjetër që ka të bëjë me përgatitjen e veprës penale duke përshkruar dorëzimin e pushkës-snajperkës për çdo ditë M.t ndërsa revolen dhe eksplozivin e kanë mbajtur për vete nuk janë të besueshme pasi nuk janë dorëzuar nga ky dëshmitar revolja dhe eksplozivi e po ashtu oficerët policor me daljen në vendin e ngjarjes ku ky dëshmitar pretendon se kanë gjuajtur me armë për kinse për të ushtruar nuk është gjetur asnjë gëzhojë e po ashtu nga CD-eja shihet se nuk janë zbatuar dispozitat ligjore përkitazi me daljen në vendin e ngjarjes ku nuk ishte i pranishëm gjyqtari i procedurës paraprake, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij e as nuk ka dëshmi se janë njoftuar nga prokuroria se do të bëhet vendëshiqimi. Edhe dëshmia e këtij dëshmitari përkitazi me përgatitjen e vrasjes së të dëmtuarit P.R. nuk përputhet me dëshminë e vetë të dëmtuarit që ka deklaruar se nuk ka pasur ndonjë hasmëri me të akuzuarin përveç një rasti që ka pasur i akuzuari me të ndjerin M.K. por asnjëherë nuk kanë pas konflikte me të akuzuarin e nga kjo me të drejtë gjykata e shkallës së parë nuk ka mundur të nxjerr motivin që i akuzuari do të kishte për ta privuar nga jeta P.R.n, e që bazuar në këto që u cekën më lartë nuk ka mundur të vërtetohet se në veprimet e të akuzuarit M.Q. qëndrojnë elementet e veprës penale të Vrasjes së rëndë nga neni 179 par.1 nën.par 1.6 dhe 1.9 lidhur me veprën penale bashkim kriminal nga neni 34 par.1 të KPRK e që ka mbet në tentativë nga neni 28 të KPRK dhe vepra penale Mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK.

Meqë aktgjykimi nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nuk kemi as shkelje të Ligjit Penal e që do të kushtëzonte anulimin e aktgjykimit.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.172/2017, më 11.05.2018

Procesmbajtësi,
Kimete Veseli

Kryetari i kolegjit- gjyqtari
1. Mejreme Memaj_____

Anëtarët e kolegjit:

2. Driton Muharremi_____

3. Afrim Shala _____